



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 15, Datë 04/03/2013

Mbështetur në informacionin e marrë nga Koalicioni Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve (BKTF) dhe bazuar në urdhërin nr. 53, datë 03.12.2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur procedurat e hetimit administrativ, lidhur me ushtrimin e dhunës ndaj shtetasit (të mitur) _____ në Tiranë, më datë 24.11.2012, nga dy punonjës të Policisë së Shtetit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër morri hapat e mëposhtëm:

Sipas informacionit të marrë nga Koalicioni BKTF, dy punonjës të Policisë së Shtetit pasi kanë evidentuar një të mitur tek ka marrë një flamur nga zbulimet e vendosura nga Bashkia Tiranë në kuadër të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, e kanë ndaluar dhe kanë ushtruar dhunë ndaj tij. Bashkëngjitur informacionit të mësipërm, Koalicioni BKTF ka depozituar pranë Komisionerit dhe pamjet filmike¹ të regjistruara gjatë ndalimit të të miturit.

Në pamjet filmike audiovizive të depozituara nga Koalicioni BKTF, dallohej qartë i mituri² me një flamur në duar, i cili është ndaluar dhe mbahet nga punonjësi i Policisë së Qarkullimit Rrugor. Pas pak, në vendin ku mbahej i mituri, ka ardhur një tjetër punonjës i Policisë së Shtetit, i cili ka marrë në dorëzim të miturin dhe i ka vendosur prangat, duke ia lidhur duart prapa shpine. Gjatë shoqërimit për në makinën e Policisë, punonjësi i Policisë ka shtyrë të miturin e më pas e ka qëlluar me pëllëmbë disa herë në shpinë.

Përsa më sipër dhe bazuar në nenin 32/c, të ligjit nr. 10 22, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të ligjit dhe në funksion të tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nxori Urdhërin nr. 54, datë 03.12.2012, për kryerjen e hetimit administrativ pranë Komisarariatit të Policisë nr.2, Tiranë.

¹ Pamje të marra nga një kamera amatore
të cilës ka marrë flamurin

Në zbatim të Urdhërit nr. 54, inspektorët e Drejtorisë së Hetim-Inspektimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kryen inspektimin pranë Komisarariatit të Policisë nr. 2, me objekt:

- Identifikimin e të miturit të dhunuar,
- Identifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj të miturit,
- Procedurat e ndjekura nga Policia e Shtetit, gjatë ndalimit dhe shoqërimit të të miturit në Komisariatin nr. 2 Tiranë,
- Si dhe masat që janë marrë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit.

Në inspektimin e zhvilluar më datë 07.12.2012 në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë, inspektorët e KMD-së u takuan me z. _____, Shef i Patrullës së Përgjithshme pranë këtij Komisaritati.

Sipas z. _____ a punonjësit e Policisë, të cilët dallohen në videoregjistrim janë, z. _____ punonjës i Komisarariatit të Policisë nr. 2, Tiranë dhe z. A _____ punonjës i Policisë së Qarkullimit Rrugor, Tiranë, ndërsa i mituri i dhunuar quhej _____ i datëlindjes 12.04.1997, banor i Njësisë Bashkiake nr. 11 Tiranë.

Përsa i përket të miturit, sipas z. _____ ai nuk është shoqëruar nga z. _____ ambjentet e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë dhe për këtë arsye nuk mund të na siguronte asnjë dokument mbi procedurat e ndjekura nga Komisaritati i Policisë, për shoqërimin e të miturit.

Në vijim të inspektimit z. _____ informoi inspektorët e KMD-së se ndaj punonjësit të Policisë, z. _____ filluar ecuria disiplinore nga ana Drejtorisë së Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në momentin e marrjes dijeni të situatës së ndodhur, ai është pezulluar nga detyra nga ana e drejtuesve të Komisarariatit të Policisë nr. 2, Tiranë.

Përsa më lart, më datë 13.12.2012, nëpërmjet shkresës me nr. 464/2 prot., Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, informacion mbi ecurinë disiplinore të punonjësit të policisë z. Kastriot Cenollari.

Në përgjigjje të saj më datë 11.01.2013, me anë të shkresës nr. 6375/4 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit informoi Komisionerin se Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ka kryer verifikimet dhe hetimet e nevojshme dhe në përfundim ka rekomanduar që Inspektor _____ r shkelje të rëndë disiplinore, të parashikuar në nenin 11, pika 5 “Kryerja e veprimeve të pahijshme”, pika 12 “Shkelje ose mosushtrim të kompetencave të policisë” dhe 14 “Përdorimi i paligjshëm ose i paarsyeshëm i forcës”, të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit, miratuar me V.K.M. nr. 786 datë 04.06.2008, të ndëshkohet me masën disiplinore “Përrjashtim nga Policia”.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Pas përfundimit të hetimeve të kryera nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u konstatua se, gjatë ndalimit të të miturit punonjësi i Policisë së Qarkullimit Rrugor Tiranë, nuk ka ushtruar dhunë ndaj të miturit . Ai ka dorëzuar të miturin tek punonjësi i Policisë së Komisarariatit nr. 2 Tiranë, z. " " i cili gjatë shoqërimit të të miturit për në mjetin e policisë ka ushtruar dhunë ndaj tij.

Përsa më lart, veprimet e kryera nga z. ndaj të miturit bien ndesh me **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, ku në nenin 54, pikën 1, të saj shkruhet se: *“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.”*, si dhe në pikën 3 *“Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.”*

Gjithashtu bazuar në nenin 3, pika 2 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 **“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”**, *“Diskriminim i drejtpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”*, konstatohet se veprimet e kryera nga z. ndaj të miturit, përbëjnë objekt të diskriminimit të drejtpërdrejtë për shkak të moshës.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma c), si dhe pika 2 e këtij neni, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 **“Për mbrojtjen nga diskriminimi”** dhe pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të administruara, Komisioneri,

VENDOSI:

1. **Konstatimin e diskriminimit**, në lidhje me ushtrimin e dhunës ndaj të miturit , në veprimet e kryera gjatë detyrës nga punonjësi i Policisë së Shtetit, z "
2. Bazuar në nenin 35, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", "Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit ose personit juridik privat", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi **rekomandon** që:
 - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, mbështetur në rekomandimin e Drejtorisë së Standardeve Profesionale, të bëjë përjashtimin e menjëhershëm të z. nga Policia e Shtetit.
 - Informimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi masat e marra në lidhje me zbatimin e rekomandimit.



166 prot
04.03.2013

Konceptoi: R. Babaj
Miratoi: V. Bushati
Date: 31.01.2013

Bushati '13

